



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:061160
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05626086

C-IV.-24-0024

Ankuesi

A Z

Përfaqësuar nga B B, avokat në Prishtinë.

Kundër:

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Ganimete Puka, me 26 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- APROVOHET** ankesa si pjesërisht e bazuar dhe **ndryshohet** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PRN126-0190, datë 31 mars 2015.
- OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit **A Z** në emër të kompensimit për paga të papaguara për 36 muaj qershor 2011 deri në qershor 2014, t’i paguaj **shumën prej 4,248.00 €** (katërmijë e dyqindën e katër dhjetë e tete euro) dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t’i paguaj shumën prej 424.80 € (katërqind e njëzet e katër euro e tetëdhjetë centë).
- Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit t’ia paguaj shpenzimet e taksës gjyqësorë në shumë prej **238.00 €**,
- Pjesa tjetër e kërkesës së ankuesit, në shumën prej 11.902.00 €, (njëmbëdhjetëmijë e nëntëdhjetë e dy euro) si dhe shpenzimet e procedure shuma prej 208€, refuzohet si e pa bazuar.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 29 prill 2015, përfaqësuesi i autorizuar (duke vepruar në emër të ankuesit) dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRN126-0190, të datës 31 mars 2015, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim për paga të papaguara për periudhën nga muaji tetor 2003 deri në qershor 2014 në shumë prej 15,340.00 € nga NSH “Auto Prishtina” (në likuidim). Përfaqësuesi i ankuesit pohoi se, duke qenë se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompozimin e pagave të papaguara, i njëjti është legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura. Pala paditëse duke i pas parasysh gjitha pohimet të thëna në ankesë i propozon gjykatës që ti shqyrtoj gjitha rrethanat, provat e prezantuar si dhe ato që gjenden në shkresat e lëndës si dhe në mënyrë ex-officio të konsideroj shkeljet absolute të dispozitave procedurale dhe materiale, pasi që ka të bëjë me një numër të madh të punonjësve që po ju shkelet e drejta për kompensimin e pagave për punën e kryer.

Parashtruesi ka bashkangjitur: autorizimin për përfaqësim, vendimin e kundërshtuar, listën e punëtorëve aktiv të cilët nuk kanë marr rrogat sipas kontratës së punës dhe kontrata e punës me NSH në fjalë, kontratën e punës.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 01 prill 2022 parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. AKP pohoi se AL, me rastin e vendosjes, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. Tutje, pohon se ankuesi nuk ka parashtruar ndonjë argument se cila dispozitë e Ligjit për AKP është aplikuar gabimisht nga ana e AL. AKP gjithashtu pohon se ankesa e ankuesit është pabazuar në kuptim të dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP nga të gjitha arsyet propozoj që ankesa të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Me 22. Qershor.2022, DHPGJSK, me aktgjykimin C-IV-15-0694, e kishte refuzuar kërkesën e paditësit, me arsyetim se kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar, me gjerësisht sikur në pjesën arsyetuese të këtij aktgjykimi.

Me 22 shkurt 2024, Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme (më tej KA), me aktgjykimin nr. AC-I-22-0398-A0001, aprovoi ankesën e ankuesit si të bazuar dhe anuloi aktgjykimin nr. C-IV-15-0694, të datë 22 qershor 2022, me të cilin ankesa e ankuesit kundër vendimit të AL ishte refuzuar si e pabazuar. KA, ndër të tjera arsyetoi se: “...shkalla e parë e DHPGJS-së kishte vendosur në merita pa i shqyrtuar kushtet e pranueshmërisë së ankesës të parapara me nenin 74 të ligjit për DHPGJS. Për më tepër KA ka vlerësuar se ankesa e ankuesit nuk mund të konsiderohet tërësisht e parashkruar për faktin se i njëjti kishte parashtruar një provë, një listë të punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marrë rrogat sipas kontratës së punës të datës 12 qershor 2014. Kjo do të thotë se 36 muaj paraprak deri në momentin kur NSH kishte hyr në procedurë të likuidimit me 21 korrik 2014, nuk ishin parashkruar.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor

Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit i kontestuar) parasheh që: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”* .

Neni 87, i Ligjit të Punës, parasheh së, të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Neni 353 i LMD/së, Nr.04/L 77, (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), që parasheh kërkesat periodike, së kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike aksesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte të themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i rregullt me kontratë të punës në NSH “Autor Prishtina-Prishtinë (në likuidim)”, me pagë mujor prej 203.20€. Nuk ka qenë kontestuese as fakti se ankuesi për punë e kryer kishte realizuar për çdo muaj nga 85 €, si akontacion .

Ankuesi, bazën e kërkesës së tij ndër të tjera e mbështet në: vendimin e kundërshtuar, listën e punëtorëve aktiv të cilët nuk kanë marr rrogat sipas kontratës së punës, kontrata e punës me NSH në fjalë, si dhe në pohimet e parashtruara në ankesë.

E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se ndër të tjera kërkesa e tij për kompensimin e pagave të papaguara është parashkruar .

Nga lista e punëtorëve aktiv të cilët nuk kanë realizuar të ardhurat personale sipas kontratës së punës , vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH “Auto Prishtina” në periudhën kohore prej muajit tetor 2003 deri në qershor 2014, kohë edhe kur shumica e aseteve të NSH-së janë shitur apo NSH është privatizuar dhe si pasojë marrëdhënia e punës së ankuesit i ka pushuar.

Nga Lista e punëtorëve aktivë të cilët nuk i kanë realizuar të ardhurat personale , sipas kontratës së punës nr. 4, datë 12 qershor 2014 lëshuar nga NSH-ja, për periudhën kohore tetor 2003 – qershor 2014, (e cila nuk kontestohet nga e paditura sa i përket lartësisë së kërkesës) vërtetohet fakti se ankuesi kishte punuar në NSH dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh ankuesit disa paga për periudhën tetor 2003 – qershor 2014 në shumë prej 15,340.00 €.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara provat e cekura më lartë për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën e lartcekur dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se NSH nuk i ka mbetur borxh pagat, ashtu siç ka pretenduar ankuesi. Meqenëse e paditura nuk e ka kontestuar periudhën kohore të pagave të papaguara dhe as lartësinë apo shumën totale të pagave të papaguara të kërkuara nga ankuesi, si dhe nuk ka ofruar asnjë provë që do mund të rrëzonin pretendimet e ankuesit, gjykata e aprovon pjesërisht kërkesën e tij.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej **4,248.00 €**, gjykata i njeh ankuesit 36 paga të papaguara. Gjukata ia njeh ankuesit pagat mujore të papaguara nga muajin qershor 2011 e deri në qershor të vitit 2014, duke u bazuar në Neni 353 i LMD/së, Nr.04/L 77, pasi që konsideron se kjo pjesë e kërkesë nuk është e parashkruar, dhe duhet kompensuar, .

Ndërsa pjesa tjetër e kërkesë së paditësit për pagat e papaguara për muaji tetot 2003, deri në qershor 2011, shumën prej 11.902.00 €, refuzohen për shkak të parashkrimit.

Gjukata ka vlerësuar dhe analizuar edhe pretendimin e të autorizuarit të ankuesit se kemi ndërprerjeje të parashikimit, mirëpo një pretendimi i tillë është i pa qëndrueshëm dhe i pa mbështetur në prova dhe ligj , pasi që me asnjë provë të vetme nuk u provuar se ankuesi e kishte kërkuar pjesën tjetër të pagës se pa paguar, në rastin konkret pjesa tjetër e pagave të pa paguar duhet të llogarite si mos përmbushje e detyrimit të paditurës në raport me paditësin , dhe kjo pjesë llogarit si borxhi i pa paguar, dhe nuk hynë në institutin e ndërprerjes së parashikimit, dihet kur kemi ndërprere të parashikimit , siç përcaktohet me dispozita ligjor të nenin 372, të LMD/së, së, për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin, për çka edhe kjo pjesë e refuzua.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin të paditurës se kërkesa e ankuesit është në tërësi e parashkruar, është i pa bazuar për pjesën e aprovua . Gjykata vlerëson se për periudhën qershor 2011 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, përkatësisht privatizimit të N.Sh-së. Kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa ankuesit është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore, të lartcekura (neni 353 të LMD) .

Nisur nga kjo gjendje dhe duke marrë parasysh faktin se lartësia e kompensimit në emër të pagave të papaguara, nuk është kontestuar shprehimisht nga AKP-ja, gjykata ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit meqë siç është arsyetuar më lartë një pjesë e pagave të pa paguar, ndërsa pjesa tjetër ishte parashkruar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 406.80 €, në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Kërkesa mbi kompensimin e taksave gjyqësore, për ankuesin, si në pikën 4 (katër) të dispozitivit u vendos në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS.

Bazuar në nenin 6.2 lidhur me nenin 6.1 të Rregullores për tarifën e avokatëve, datë 18 mars 2017, vendosi si në pikën 4 (katër) të dispozitivit të këtij Aktgjykimi. Shuma e gjykuar prej 238.00 Euro, për taks gjyqësor për ankesë 30€, dhe 208 € për ankesë / parashtrësë, ndërsa pjesa tjetër prej 208 €, për parashtrësë- përgjigje në urdhër në rastin konkret nuk i takojnë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r e

Ganimete Puka